

Mogo Albania sh.a

**Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2017
dhe Raporti i audituesit të pavarur**



MOGO ALBANIA SHA

PËRMBAJTJA:

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRAT E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	4
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	5
2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE	5
3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL	9
4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR	14
5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE	17
6. AKTIVE TË TJERA	17
7. TE ARKETUSHME NGA QIRAJA FINANCIARE	17
8. AKTIVE MONETARE DHE EKUIVALENTËT ME TO	18
9. KAPITALI AKSIONAR	19
10. HUA NGA PALE TE LIDHURA	19
11. DETYRIME PER TATIME DHE SIGURIME	19
12. DETYRIME TË TJERA	19
13. SHPENZIME NGA INTERESI, NETO	20
14. SHPENZIME OPERATIVE	20
15. SHPENZIME PERSONELI	20
16. HUMBJE NGA KURSET E KËMBIMIT, NETO	21
17. TATIM FITIMI	21
18. PALËT E LIDHURA	21
19. ANGAZHIME DHE DETYRIMET E KUSHTEZUARA	22
20. VLERA E DREJTE	23
21. NGJARJE TË MËPASSHME	23

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve të Mogo Albania sh.a.

Opioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Mogo Albania sh.a. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më datë 31 dhjetor 2017, si dhe pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për periudhën prej 28 mars 2017 deri më 31 dhjetor 2017, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Mogo Albania sh.a. paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, si dhe të rezultatit të saj financier dhe të fluksit të mjeteve monetare për periudhën prej 28 mars 2017 deri më 31 dhjetor 2017, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri (Kodi IEKA), dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvëç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përvëç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financier të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqerisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmérinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmérinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Mogo Albania sh.a, përvèç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young *En.L.Fid Analloress*

31 maj 2018
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar


MOGO ALBANIA SHA

Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2017

	Shënimë	31 dhjetor 2017 në Lekë
Aktive afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	5	792,280
Të arkëtueshme nga qiraja financiare		370,770
Aktiv tatimor i shtyre		1,544,043
Totali i aktiveve afatgjata		2,707,093
Aktive afatshkurtra		
Aktive të tjera	6	450,511
Të arkëtueshme nga qiraja financiare	7	1,204,286
Aktive monetare dhe ekuivalentët me to	8	32,839,964
Totali i aktiveve afatshkurtra		34,494,761
Totali aktiveve		37,201,854
Kapitali dhe detyrimet		
Kapitali aksionar		
Kapitali i paguar	9	20,000,000
Humbje te mbartura		(9,069,804)
Totali i kapitalit		10,930,196
Detyrime afatgjata		
Hua nga palet e lidhura	10	23,931,000
Totali i detyrimeve afatgjata		23,931,000
Detyrime afatshkurtra		
Hua nga palet e lidhura, pjesa afatshkurter		590,315
Detyrime tatimore, sigurime shoqerore dhe shendetesore	11	346,552
Detyrime të tjera	12	1,403,791
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,340,658
Totali i detyrimeve		26,271,658
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		37,201,854

Pasqyra e pozicionit finanziar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

MOGO ALBANIA SHA

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
për periudhën nga 28 mars 2017 deri më 31 dhjetor 2017

Shënimet	Periudha nga 28 mars 2017 deri më 31 dhjetor 2017		
			në Lekë
Të ardhura nga interesë	13		6,755
Shpenzime për interesa	13		(590,315)
Të ardhura neto nga interesat			(583,560)
Humbja nga kurset e kembimit	18		(8,634)
Totali i te humbjeve financiare, neto			(8,634)
Shpenzime personeli	16		(5,106,351)
Shpenzime administrative	15		(4,914,038)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	5		(1,264)
Totali i shpenzimeve operative			(10,021,653)
Humbja para tatimit			(10,613,847)
Shpenzime tatim fitimi	19		-
Tatim fitim i shtyre			1,544,043
Humja e vitiit			(9,069,804)

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

MOGO ALBANIA SHA

Pasqyrat e Ndryshimeve në Kapital
për perindhën nga 28 mars 2017 deri më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar i paguar	Humbja e periudhës	Totali
	në Lekë	në Lekë	në Lekë
Gjendja më 28 mars 2017	-	(9,069,804)	(9,069,804)
Humbja e periudhës	-	-	-
Te ardhura te tjera gjithperfshirese	-	(9,069,804)	(9,069,804)
Totali i humbjes dhe te ardhurave gjithperfshirese	-	-	20,000,000
Emetim kapitali me kontribut në para	20,000,000	-	20,000,000
Gjendja më 31 dhjetor 2017	20,000,000	(9,069,804)	10,930,196

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

MOGO ALBANIA SHA

Pasqyra e Flukseve të Parasë

Për periudhën nga 28 mars 2017 deri më 31 dhjetor 2017

Shenime	Periudha nga 28 mars 2017 deri më 31 dhjetor 2017	në Lekë
Flukset monetare nga aktiviteti operativ		
<i>Humbja para tatimit</i>	(10,613,847)	
Rregullimet për:		
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	1,264	
Shpenzime provigjoni	16,019	
Të ardhura nga interesë	(6,755)	
Shpenzime për interesë	590,315	
Fluksi monetar nga aktiviteti operative perpara ndryshimeve ne kapitalin punues	(10,013,004)	
Rritje në të arkëtueshme nga qeraja financiare	(1,584,320)	
Rritje në aktive të tjera	(450,511)	
Rritje në detyrime të tjera	1,403,791	
Rritje ne detyrime për tatime dhe sigurime	346,552	
Fluksi monetar nga aktivitetet operative	(10,297,492)	
Interesi i arkëtuar	-	
Interesi i paguar	-	
Tatim fitimi i paguar	-	
Flukset monetare të perdonura në aktivitetet operative	(10,297,492)	
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(793,544)	
Flukset monetare të perdonura në aktivitetet investuese	(793,544)	
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Flukse hyrese nga hua të marra	23,931,000	
Kapitali i paguar	20,000,000	
Flukset monetare nga aktivitetet financuese	43,931,000	
Rritja ne mjete monetare	32,839,964	
Mjetet monetare ne fillim te periudhes	-	
Mjetet monetare ne fund te periudhes	32,839,964	


Pasqyrat financiare të Shoqërisë për periudhën e mbyllur me 31 dhjetor 2017 të përgatitura nga Kazazi Consulting, u aprovuan nga administratori dhe u nënshkruan si më poshtë me date 30 maj 2018:

Alkion Elezi



Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqen 23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Kazazi Consulting shpk



MOGO ALBANIA SHA

Shënime të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria MOGO Albania sh.a. (më poshtë referuar si "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 28 mars 2017 dhe pranë Degës së Tatimeve dhe Taksave Tiranë me NIPT L71528013A. Shoqëria në datën 10 tetor 2017 ka marë licencën me nr 41 nga Banka e Shqiperise për të ushtruar aktivitetin e saj financiar. Veprimitaria e Shoqërise rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga akti i themelimit dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërises është ai i aktivitetit financiar jo bankë kryesisht qira financiare.

Shoqëria zotërohet 100% nga aksioneri i vetëm, Mogo Finance, me seli në Luksemburg.

Administrator i Shoqërisë është Z. Alkion Elezi. Anëtarët e këshillit të administrimit të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2017 janë:

1. Aleksandrs Cernagins - Anëtar
2. Kristine Mora - Anëtar
3. Maris Kreics – Anëtar

Selia kryesore e Shoqërisë ndodhet në Njësia Bashkiake nr 2, Rruga e Elbasanit, Pallati Edil Al-It, American 2, Zyra 201, Tiranë. Numri i punonjësve të Shoqërisë me 31 dhjetor 2017 është 5 (pesë).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të "Mogo Albania" sh.a. janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazen e kostos historike.

2.3 Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë. Pasqyrat financiare nuk përfshijnë rregullimet që do të rezultonin në qoftë se kompania nuk do të ishte në kushtet e aktivitetit në vijimësi.

2.4 Periudhat krahasimore

Për vitin ushtrimor 2017 shoqëria nuk ka periudha të mëparëshme krahasimore, sepse aktiviteti i saj ka filluar me 28 mars 2017. Ky është viti i parë i aktivitetit dhe raportimit të Shoqërisë.

2.5 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.6 Paraqitja e pasqyrave financiare

Paraqitja e vlerave në aktive dhe detyrime për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 është bërë sipas ndarjes në aktive afatshkurtra e afatgjata dhe detyrime afatshkurtra e afatgjata.

2.7 Vleresime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqrise dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë pëershkuar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

MOGO ALBANIA SHA

Shënimë të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave (vazhdim)

2.8 Zbatimi i ndryshimeve në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

2.8.1. Standarde të miratuara por që ende nuk kanë hyrë në fuqi

Standardet dhe interpretimet qe jane miratuar, por nuk kane hyre ende ne fuqi per periudhen raportuese Jane paraqiture me poshte. Shoqeria do adoptoje vetem ato standarde te cilat do jene te aplikueshme per te, me nisjen e aktivitetit te saj ne periudhen pasardhese.

✓ SNRF 9 Instrumentat Financiare

Në korrik 2014, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), publikoi vesionin final të SNRF 9 Instrumentat Financiare, i cili zëvendësoi SNK 39 Instrumentat Financiare për periudhat vjetore më ose pas 1 janar 2018, me aplikim të hershëm të lejuar. Ky aplikim i hershëm është i lejuar për periudhat e raportimit që fillojnë pas dhënies së SNRF 9 më 24 korrik 2014 duke zbatuar të gjitha kërkesat e këtij standardi në të njëjtën kohë. Ndryshe, njësitë ekonomike mund të zgjedhin që në fillim të zbatojnë vetëm kërkesat për paraqitjen e fitimeve dhe humbjeve nga detyrimet financiare të përcaktuara si vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, pa zbatuar kërkesat e tjera në standard.

SNRF 9 është efektiv për periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar 2018, ku informacioni krahasues nuk është i detyrueshëm. Drejtimi do te vleresoj gjate vitit 2018 ndikimin e SNRF 9. Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 drejtimi nuk është ende në gjendje te jape informacion sasior te ndikimit nga aplikimi i kerkesave te SNRF 9.

(a) Klasifikimi dhe Matja

Shoqeria nuk pret ndonjë ndikim në bilancin kontabël të saj ose në kapital për përdorimin e kerkesave të SNRF 9 për klasifikimin dhe matjen. Shoqeria pret të vazhdojë të përdorë matjen me vlerën e drejtë të të gjitha aktiveve financiare të cilat mbahen momentalisht me vlerë të drejtë. Huatë dhe llogaritë e arketueshme mbahen për të mbledhur mjete monetare të kontraktuara dhe pritet të jepin mjete monetare që përfaqësojnë vetëm pagesa principali dhe interesit. Shoqeria pret që këto do vazhdojnë të maten me kosto të amortizuar edhe sipas SNRF 9. Megjithatë Shoqeria do vazhdojë të masë efektin dhe karakteristikat e këtyre instrumentave sipas SNRF 9.

(b) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

SNRF 9 gjithashtu do të ndryshojë rrënjosht metodologjinë e zhvlerësimit të humbjeve të kredisë. Standardi do të zëvendësojë metodën e humbjeve të ndodhura të SNK 39 me një metodë humbjeje të pritshme (ECL). Shoqerise do t'i kërkohet të regjistrojë një provigjon për humbjet e pritshme për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në FVPL (Vlerën e Drejtë nga të Ardhurat dhe Shpenzimet), së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Provigioni bazohet në humbjet e pritura të kredisë të lidhura me probabilitetin e mospagimit në dyndëdhjetë muajt e ardhshëm përvëçse nëse nuk ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, rast në të cilin, provigioni bazohet në probabilitetin e mospagimit përgjatë gjithë jetës së aktivit. Shoqeria nuk pret te kete një ndikim më të rëndësishëm në kapitalin e saj përsa i përket huave dhe llogarive të arkëtueshme megjithate ajo do të bëjë një analizë më të hollësishme që do konsiderojë të gjithë informacionin e mundshëm dhe mbështetës, duke përfshire elemente të ardhshëm për të përcaktuar madhësinë e ndikimit.

(c) Kontabiliteti mbrojtës

Shoqeria beson se të gjitha marrëdhëniet e kontabilitetit mbrojtës të cilat përdoren për kontabilitet mbrojtës do të vazhdojnë të konsiderohen për kontabilitet mrojtës edhe nën SNRF 9. SNRF 9 nuk ndryshon parimet e përgjithshme sipas të cilave një entitet kontabilizon mbrojtjen efektive. Shoqeria do te vleresoj gjate 2018 ndikimin ne pasqyrat financiare te saj si rezultat i përdorimit të SNRF 9.

MOGO ALBANIA SHA

Shënimë të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017

(shumat në Lekë)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave (vazhdim)

2.8. Zbatimi i ndryshimeve në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (vazhdim)

2.8.1. Standarde të miratuara por që ende nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

✓ SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018. SNRF 15 përcakton një model me pesë-hapa që do të aplikohet për të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientin (me përjashtime të kufizuara), pavarësisht nga lloji i transaksionit të të ardhurave apo industrisë. Kërkesat e standardit do të aplikohen gjithashtu për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve mbi shitjen e disa aktiveve jo-financiare që nuk janë transaksione të veprimtarise të zakonshme të njësisë ekonomike (p.sh. shitja e aktiveve afatgjata material dhe jo-materiale).

Dhënia e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme, përfshi ndarjen e të ardhurave totale, informacionin rreth detyrimeve të performancës, ndryshimet në llogaritjen e aktiveve dhe detyrimeve të kontratës ndërmjet periudhave, gjykimeve dhe vlerësimet. Drejtimi nuk pret që ky standard të ketë një efekt në pasqyrat financiare të Shoqërinë me gjithate ai do te vleresoj gjate vitit 2018 impaktin ne keto pasqyra financiare.

✓ SNRF 16 Qiraja

SNRF 16 është lëshuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiradhënien, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përban një qira, SIC-15 Nxitjet e Qirasë Operative dhe KIS-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japid llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, ngashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy përjashtime njohjeje për qiramarrësit - dhënien me qira të aktiveve "me vlerë të vogël" (p.sh., kompjuterët personal) dhe qiratë afatshkurtra (dmth.qira me një afat kohor prej 12 muajsh ose më pak). Në datën e fillimit të një qiraje, një qiramarrës do të njohë një detyrim për të bërë pagesa të qirasë (dmth. Detyrimin e qirasë) dhe një aktiv që përfaqëson të drejtën e përdorimit të aktivit bazë gjatë afatit të qirasë (p.sh. aktivin e të drejtës së përdorimit). Qiramarrësit do t'i kërkohet të njoh veçmas shpenzimet e interesit në detyrimet e qirasë dhe shpenzimet e amortizimit në aktivin e të drejtës së përdorimit.

Qiramarrësit gjithashtu do t'i kërkohet që të rillogarisë detyrimin e qirasë me rastin e ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë të ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks apo normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rivlerësimit të detyrimit të qirasë si një rregullim në aktivin e së drejtës së përdorimit.

Kontabiliteti i qiradhënësit sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga kontabilizimi i sotëm sipas SNK 17.

SNRF 16 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi i hershëm lejohet, por jo para se një entitet të zbatojë SNRF 15. Një qiramarrës mund të zgjedhë të zbatojë standardin duke përdorur një qasje të plotë retrospektive ose një modifikim retrospektiv. Dispozitat e tranzicionit të standardit lejojnë lehtësimë të caktuara. Shoqeria po vlerëson ndikimin e mundshëm të SNRF 16 në pasqyrat financiare të saj.

✓ SNRF 17 Kontratat e Sigurimit

SNRF 17 është efektive për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, me shifra krahasuese të kërkuar. Aplikimi i hershëm është i lejuar, me kusht që njësia ekonomike të zbatojë gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 më ose përpëra datës së zbatimit të parë të SNRF 17. Nuk është i aplikueshëm për Shoqerine.

MOGO ALBANIA SHA

Shënimë të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave (vazhdim)
- 2.8. Zbatimi i ndryshimeve në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (vazhdim)
 - 2.8.1. Standarde të miratuara por që ende nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)
 - ✓ *KIRFN Interpretimi 22 Transaksionet në Monedhë të Huaj dhe Njohja në Avancë*
 - ✓ *KIRFN Interpretimi 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat*
 - ✓ *SNRF 2 Klasifikimi dhe Matja e Transaksionet të Pagesave të bazuara në aksione – Ndryshim i SNRF 2*
 - ✓ *Zbatimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimit – Ndryshim i SNRF 4*
 - ✓ *SNA 40 Transferimi i aktiveve afatgjata material te investimit*
 - ✓ *Ndryshim i SNRF 10 dhe SNK 28: Shitia ose Kontributi ne Aktive ndërmjet një Investitori në pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët*
 - ✓ *SNK 28 Interesat afatgjatë në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta*

Cikli i Përmirësimeve vjetore 2014-2016 (lëshuar në Dhjetor 2016)

Permiresimet e me poshtme nuk janë te aplikueshme per Shoqerine:

- ✓ *SNRF 1 Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar – Fshirja e përjashtimeve afatshkurtra për adoptuesit për herë të pare*
- ✓ *SNA 28 Investimet në Pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta - Sqarime se matja e investimeve me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes është një zgjedhje investimi-sipas-investimit*

Cikli i përmirësimeve vjetore 2015-2017 (lëshuar në Dhjetor 2017)

Permiresimet e me poshtme nuk janë te aplikueshme per Shoqerine:

- ✓ *SNRF 3 Kombinimi i Bizneseve – Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët*
- ✓ *SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët.*
- ✓ *SNA 12 Tatimi mbi të Ardhurat – Pasojat e tatimit mbi fitimin të pagesave mbi instrumentat financiarë të klasikuara si kapital.*
- ✓ *SNA 23 Kostot e Huamarrjes - Kostot e huamarrjes të përshtatshme për kapitalizim*

2.8.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara

Standardet dhe amendimet e reja te paraqitura me poshtë janë te zbatueshme per periudhat financiare që fillojnë me ose pas dates 1 janar 2018, gjithsesi, ato nuk janë te aplikueshme per Shoqerine, deri tani.

- ✓ *Ndryshime në SNA 7*
- ✓ *SNA 12 Njohja si Aktiv e Tatimit të Shtyrë për Humbjet e Parealizuara – e amenduar*
- ✓ *SNRF Deklarata e Praktikës 2: Marrja e Vendimeve të Materialitetit*

Cikli i Përmirësimeve vjetore 2014-2016 (lëshuar në Dhjetor 2016)

Permiresimet e me poshtme nuk janë te aplikueshme per Shoqerine:

- ✓ *SNRF 12 Shprehja e interesave në Njësi të tjera.*

MOGO ALBANIA SHA

Shënime të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

3. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë të gjitha peridhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në datën e raportimit të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në Leke me kursin në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jomonetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj, rivlerësohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimi ose humbja neto nga ndryshimimi i kurseve të këmbimit kalon ne pasqyren e te ardhurave gjithperfshire.

Kursi i këmbimit të aplikuar ne konvertimin e aktiveve dhe detyrimeve monetare ne monedhe te huaj më 31 Dhjetor 2017 ka qënë si më poshtë :

31 dhjetor 2017	
Usd/Lek	111.1
Eur/Lek	132.95

3.2. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një përiudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Llogaritia e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifat dhe shumat e paguara ose të marra, kostot e transaksionit të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë bilancit të një mjeti apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesit efektiv.

3.3. Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Te ardhurat nga komisioneve qe lidhen me disbursimin e qirave financiare paraqiten ne te ardhura nga interesat.

Tarifa dhe komisione te tjera përfshijnë komisione bankare që lidhen kryesisht me komisione transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që merren shërbimet.

3.4. Pagesat e qirase

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose ajo përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike dhe marrëveshja mbart të drejtën për të përdorur aktivin.

Shoqëria si një qiramarrës

Qiratë që nuk transferojnë te shoqëria në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operacionale. Pagesat e qirasë operacionale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin.

MOGO ALBANIA SHA

Shënime të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.4. Pagesat e qirase (vazhdim)

Shoqëria si një qiradhënës (qira financiare)

Qiratë ku shoqëria transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivit klasifikohen si investim neto në qira financiare. Fillimi i qirasë është data e disbursimit të fondeve. Në këtë datë:

- një qira klasifikohet si qira financiare dhe;
- përcaktohen shumat që do të njihen me fillimin e afatit të qirasë.

Fillimi i qirasë është data në të cilën qiramarrësi ka të drejtë të përdorë aktivin e blerë me qira financiare. Kjo është data e njohjes fillestare të qirasë (p.sh. njohja e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve që rezultojnë nga investimi neto në qira financiare, sipas rastit). Në pasqyrën e pozicionit financiar, Shoqëria paraqet shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit. Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare neto.

Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të paftuara. Të ardhurat nga investimi neto ne qira financiare të njohura nga prodhuesi ose tregtar qiradhënës në fillim të afatit të qirasë financiare janë vlera e drejtë e aktivit, ose nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të leasing-ut që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut.

Shoqëria vlerëson krijimin e fondeve rezervë për zhvlerësimin e investimit neto në qira financiare, duke përdorur politikat e përdorura për zhvlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura me koston e amortizueshme (p.sh. qiratë financiare, llogaritë e arkëtueshme), duke qënë se kredite dhe investimi neto në qira financiare kanë karakteristika te ngjashme rreziku.

3.5. Tatimet

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

3.5.1. Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatushëm vjetor. Fitimi i tatushëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje në Pasqyrën e të ardhurave gjithperfshirese për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatushme ose të zbritshme në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk tatohen apo njihen si të pazbritshëm. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përvèç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatushme për vitin, duke përdorur normat tativore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tativor Shqiptar. Të ardhurat e tatushme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave shpenzimeve të caktuara, siç kërkohet nga ligji Shqiptar.

3.5.2. Tatim fitimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferençat e përkohshme midis kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tativore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferençat e përkohshme të tatushme. Aktivet tativore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferençat e përkohshme të tatushme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatushme do të janë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen. Vlera kontabël neto e aktiveve tativore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatushme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivit të mund të rikuperohet.

MOGO ALBANIA SHA

Shënimë të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.5. Tatimet (vazhdim)

3.5.2. Tatim fitimi i shtyrë (vazhdim)

Detyrimet dhe aktivet e shtyra tativore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivi realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Matja e detyrimeve dhe aktiveve tativore të shtyra pasqyron rrjedhojat tativore që do të vijojnë nga mënyra në të cilën Shoqëria pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

3.5.3. Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç kur lidhen me zërat që janë njohur në të ardhurat e tjera përbledhëse, ku tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në të ardhurat e tjera përbledhëse.

3.6. Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese

3.6.1. Data e njohjes

Të gjithë aktivet dhe detyrimet financiare janë njohur fillimisht në datën kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

3.6.2. Matja fillestare e instrumentave financiarë

Instrumentet financiare njihen fillimisht me kosto, e cila është vlera e drejtë e shumës së dhënë që përfshijnë komisionet e blerjes në lidhje me instrumentin finanziar. Fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të parealizuara, përfshihen në të ardhurat neto. Kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit të aktiveve apo detyrimeve financiare (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes së aktiveve apo detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje).

3.6.3. Klasifikimi i aktiveve financiare

Aktivet financiare klasifikohen në kategoritë e mëposhtme të specifikuara:

- Mjetet monetare dhe ekuivalente
- Qira financiare

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe çregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

3.6.4. Klasifikimi i detyrimeve financiare dhe kapitalit

a. Klasifikimi si borxh ose kapital

Instrumentat e borxhit dhe kapitalit të emetuar nga shoqëria janë klasifikuar ose si detyrime financiare ose si kapital i vet në përputhje me thelbin e marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të detyrimit financiar dhe instrumentave të kapitalit.

b. Instrumentat e kapitalit

Një instrument kapitali është çdo kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivet e Shoqërisë pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Instrumentat e kapitalit neto të emetuara nga Shoqëria janë të njohura për shumën e arkëtuar, neto nga kostot direkte të emetimit.

MOGO ALBANIA SHA

Shënimë të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.7. Mosnjohja (çregjistrimi) e aktiveve dhe detyrimeve financiare

3.7.1. Aktivet financiare

Shoqëria nuk e njeh më një aktiv financiar (e çregjistron) nëse të drejtat kontraktuale përfitimin e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat përfitimin e kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilët transferohen te një njësi tjeter të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

3.7.2. Detyrimet financiare

Shoqëria çregjistron detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur, detyrimet e Shoqëria janë shkarkuar, anulluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Një aktiv ose detyrim njihet përfitimin e shërbimit, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme përfitimin e shërbimit (detyrim).

3.8. Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetërën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Shoqëria ka të drejtën ligjore përfitimin e kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standaret kontabël, ose përfitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksione të ngashme si ato në aktivitetin tregtar të Shoqërisë.

3.9. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Në çdo datë bilanci Shoqëria vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të ndryshëm nga mjetet monetare dhe ekuivalentet me to, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuara kur ka evidencë që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Shoqëria konsideron mundësinë e zhvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv te qirave financiare. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen përfshirë zhvlerësim specifik.

Të gjithë aktivet e rëndësishme të cilat nuk zhvlerësohen specifisht vlerësohen kolektivisht përfshirë çdo vlerësim që ka lindur por nuk është identifikuar akoma. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbartura me kosto të amortizuar) me karakteristika të ngashme rreziku.

Evidencë objektive që aktivet financiare të janë të zhvlerësuara mund të përfshijnë mospagimin ose shkeljet nga huamarrësi, ristrukturimin e qirave financiare ose paradhënieve nga Shoqëria me kusht që Shoqëria nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv përfshirë çdo instrument financiar, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tillë si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

Aktualisht shoqëria ka bere një vlerësim ne grup per qirate e saj financiare ne vleren 1% mbi principalin dhe interesin e perllogaritur.

3.10. Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to

Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma në Bankat e nivelit te dyte ne Shqipëri, të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël. Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

MOGO ALBANIA SHA

Shënime të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.11. Investime në qira financiare

Hua dhe paradhënie për klientët (përfshirë qiratë financiare) përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuara në një treg aktiv, dhe që shoqëria nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përvèç:

- Atyre që shoqëria ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që shoqëria gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që shoqëria, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

Pas matjes fillestare me vlerën e drejtë, shumat e huave dhe paradhënieve për klientët janë matur më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit nominal. Kostot e transaksionit janë kosto rritura të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen, shitjen ose nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivit apo detyrimit financiar.

3.12. Aktive afatgjata materiale

a. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

b. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përsitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në menyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

c. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet mbi koston e blerjes së aktivit të zvogëluar me vlerën e tij të mbetur. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë zbritëse përgjatë jetës së aktivit.

Këto aktive janë amortizuar mbi vlerën kontabël neto me përqindje 33%. Për llogaritjen e tatim fitimit, janë mbajtur parasysh normat fiskale sipas legjislacionit tatimor ne fuqi dhe janë bërë axhustimet përkatëse duke e kaluar në shpenzim të pa njohur diferençën midis normës së përllogaritur dhe asaj fiskale.

3.13. Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim të shlyhet midis palëve të palidhura me njëra-tjetër, të mirinformuara që kryejnë një transaksion në mënyrë të vullnetshme në datën e matjes.

Vlera e drejtë e instrumentit finanziar përcaktohet si çmimi që do të përftohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarresve të tregut në datën e matjes.

Kur është e mundur, shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuara të një tregu aktiv për atë instrument. Nëse tregu për një instrument finanziar nuk është aktiv, shoqëria kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Shoqëria nuk ka instrumenta financiare të matur me vlerën e drejtë.

MOGO ALBANIA SHA

Shënimë të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.13. Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Për qëllime dhënjeje të informacioneve shpjeguese në lidhje me vlerën e drejtë, shoqëria ka përdorur modele vlerësimi aty ku ka të dhena të observueshme tregu; nëse këto të dhëna nuk janë të disponueshme, atëherë shoqëria ka përdorur gjykimin e saj në përcaktimin e vlerave të drejta të instrumentave financiarë.

Shoqëria e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e input-eve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: çmimet e kuotuara të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rrjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuara për instrumenta identikë ose të ngashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuara për instrumenta të ngashëm ku kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferenca mes instrumentave, shiko shënimin 20.

4. Menaxhimi i riskut financiar

Aktiviteti i kompanisë është i ekspozuar kundrejt disa risqeve financiare si: riscu i kursit të këmbimit, riscu i kredisë dhe riscu i përqindjes së interesit. Menaxhimi i riskut financiar drejtohet dhe fokusohet në paparashikueshmërinë e tregut financiar dhe synon të minimizojë efektet potenciale të papëlqyeshme. Menaxhimi i riskut financiar ndërmerret nga departamenti financiar i kompanisë mëmë sipas politikave të aprovuara nga bordi.

4.1. Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria është i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euro-n. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për tu mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme.

Ekspozimi i shoqërisë ndaj kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2017 ka qenë si më poshtë:

31 dhjetor 2017

Aktivet Financiare

Të arkëtueshme nga qiraja financiare
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to
Aktive të tjera

Totali

Detyrime financiare

Hua nga palet e lidhura
Detyrime për tatime dhe sigurime
Detyrime të tjera

Totali

Pozicioni neto më 31 dhjetor 2017

	Leke	Euro	Totali
Të arkëtueshme nga qiraja financiare	-	1,575,056	1,575,056
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	18,022,143	14,817,821	32,839,964
Aktive të tjera	450,511	-	450,511
Totali	18,472,654	16,392,877	34,865,531
Detyrime financiare			
Hua nga palet e lidhura	-	24,521,315	24,521,315
Detyrime për tatime dhe sigurime	346,552	-	346,552
Detyrime të tjera	56,651	1,347,140	1,403,791
Totali	403,203	25,868,455	26,271,658
Pozicioni neto më 31 dhjetor 2017	18,069,451	(9,475,578)	8,593,873

MOGO ALBANIA SHA

Shënimë të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017

(shumat në Lekë)

4. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

4.2. Risku i kursit të këmbimit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet analizën e ndjeshmërisë së rrezikut të kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2017 prej +/- 100 pikë bazë dhe efektin përkatës në fitimin para tatimit. Analiza me poshte llogarit efektin qe nje ndryshim i mundshem dhe i arsyeshem qe secila prej monedhave te mëposhtme mund te kete ne varesi ndaj monedhes vendase te Lek-ut shqiptar (gjithe variablat e tjera qendrojne konstante) në të ardhurat/shpenzime e vitit (në sajë të vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve jo të tregtueshme që kanë ndjeshmëri ndaj luhatjeve të vlerës së drejtë të monedhave).

Analiza e ndjeshmerise

Monedha Euro	Rritja në pikë bazë +/- 100 b.p.	31 dhjetor 2017	
		Efekti ne fitimit/humbjen para tatimit	+/- 94,755

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehur në monedhë të huaj në fund të vitit dhe një korrigjim i vlerës së tyre bëhet për një ndryshim 10% të normave në valutë. Vlerat pozitive / negative tregojnë një rritje / ulje të fitimit ose kapitalit, i cili ndodh kur LEK forcon / dobëson krahasuar me një valutë të huaj me +/- 10%.

4.2. Risku i kreditit

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë nëse klientët ose palët e tjera nuk përbushin detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë. Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është kryesisht i influencuar nga karakteristikat individuale të çdo klienti. Shoqëria krijon një fond provigjoni për zhvlerësim i cili përfaqëson vlerësimet e shoqërisë për humbjet e ndodhura në lidhje me llogaritë e arkëtueshme bazuar tërësisht në humbjet specifike të lidhura me ekspozime individualisht të rendësishme (shenimi 7).

Rreziku maksimal i ekspozimit të shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit përfaqësohet nga vlera e mbetur e seilit aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar të paraqitur më poshtë:

Të arkëtueshme nga qiraja financiare
Aktive monetare dhe ekuivalentët me to
Aktive të tjera
Më 31 dhjetor

Ekspozimi maksimal	31 Dhjetor 2017
	1,575,056
	32,839,964
	450,511
	34,865,531

4.3. Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rrreziku që një njësi ekonomike do të përballet me vështirësi përmes përbushur detyimet që lidhen me pasivet financiare. Shoqëria është e eksponuar ndaj nevojave të përditshme përburime monetare, kryesisht përmes detyimet e shlyer detyimet e krijuara gjatë ushtimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime përmes flukset e parave.

Tabela më poshtë analizon detyrimet financiare sipas maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur nga data e caktimit.

Summat e paraqitura nē tabelēn mē poshtē janē flukset e parave tē pa skontuara sīpas kontratēs. Andryshimi me vlerēn e skontuar nuk ēštē i konsiderueshēm.

31 dhjetor 2017

Aktivitet Finansiare

Mjete monetare dhe ekuivalentët me to

Të arkëtueshme nga qiraja financiare

Aktive të tjera

Totalli

Datijs - 6

Detyfime finanziare

Detyrime për tatime dhe si

1
Detyrime të

Totali

Iendeku i likuiditetit

Kumulativ

<u>Deri n� 1 muaj</u>	<u>1 - 6 muaj</u>	<u>6 - 12 muaj</u>	<u>1 - 5 vite</u>	<u>Mbi 5 vite</u>	<u>Totali</u>
32,839,964	-	-	-	-	32,839,964
80,017	454,624	669,645	226,866	143,904	1,575,056
404,552	45,959	-	-	-	450,511
33,324,533	500,583	669,645	226,866	143,904	34,865,531
346,552	-	-	-	23,931,000	24,521,315
14,034	1,389,757	-	-	-	346,552
360,586	1,980,072	-	-	-	1,403,791
32,963,947	(1,479,489)	669,645	226,866	(23,787,096)	8,593,873
32,963,947	31,484,458	32,154,103	32,380,969	8,593,873	

MOGO ALBANIA SHA

Shënimë të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
 (shumat në Lekë)

5. Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale me 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

	Pajisje informatike	Te tjera	Totali
Kosto			
Gjendje me 28 mars 2017	-	-	-
Shtesa	703,794	89,750	793,544
Pakësimë	-	-	-
Gjendje më 31 dhjetor 2017	703,794	89,750	793,544
Amortizimi			
Gjendje më 28 mars 2017	-	-	-
Shtesa	1,264	-	1,264
Pakësimë	-	-	-
Gjendje më 31 dhjetor 2017	1,264	-	1,264
Vlera kontabel e mbartur			
Vlera neto më 28 mars 2017	-	-	-
Vlera neto më 31 dhjetor 2017	702,530	89,750	792,280

6. Aktive të tjera

Zëri aktive të tjera me 31 dhjetor 2017 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017
TVSH e arkëtueshme	404,552
Shpenzime per periudha të ardhshme	45,959
Totali	450,511

TVSH e arkëtueshme pasqyron vlerën e TVSH kreditore deri ne 31 dhjetor 2017 e cila është krijuar nga TVSH-ja në blerje e shërbimeve dhe aktiveve gjate viti 2017. Shpenzimet për periudhat e ardhshme përbehen nga Leke 36,583 te clat lidhen me shpenzime te faturuara gjate 2017 por u perkasin vitit te ardhshem si edhe Leke 9,375 shpenzime te parapaguara.

7. Te arketushme nga qiraja financiare

Qirate financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 te ndare sipas afatit paraqiten si me poshtë:

	Afatgjate	Afatshkurter	Totali
Principali	379,179	1,216,221	1,595,400
Interesi i perllogaritur	-	6,515	6,515
Komisione te pafituarë	(4,617)	(6,223)	(10,840)
Zhvlerësimi	(3,792)	(12,227)	(16,019)
Totali, neto	370,770	1,204,286	1,575,056

Interesi i perllogaritur pasqyron interesin e realizuar deri më 31 dhjetor 2017 i cili do të faturohet gjate vitit 2018. Komisioni i pafituar perfaqeson komisionin e disbursimit te pafituar deri ne fund te vitit 2017. Zhvlerësimi i qirave financiare pasqyron fondin rezerve të provigjoneve i cili perllogaritet ne baze te diteve ne vonese te keyre qirave (shenimi 3.9).

MOGO ALBANIA SHA

Shënim të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
 (shumat në Lekë)

7. Te arketushme nga qiraja financiare (vazhdim)

Qirate financiare te leshuara deri me 31 dhjetor 2017 jane me norme interes i fiks. Norma mesatare e interesit efektiv te ketyre qirave eshte 52%-53% dhe kane një afat nga 12 muaj deri me 6 vite.

Analiza e fondit te zhvleresimit si edhe levizja e tij gjate vitit paraqitet si më poshtë:

*Jo ne vonese jo e zhvleresuar
 Ne vonese jo e zhvleresuar
 Te zhvleresuara
 Totali, bruto*

	Biznes	Individe	Totali
<i>Jo ne vonese jo e zhvleresuar</i>	-	1,595,400	1,595,400
<i>Ne vonese jo e zhvleresuar</i>	-	-	-
<i>Te zhvleresuara</i>	-	-	-
Totali, bruto	-	1,595,400	1,595,400

Zhvleresimi me 28 mars 2017

Shtesa gjate vitit
 Rimarrje gjate vitit
Zhvleresimi me 31 dhjetor 2017

31 dhjetor 2017

-
 16,019
 -
16,019

Me poshtë paraqitet ndarja e shumes bruto dhe te ardhurave financiare te pafituar sipas afatit:

Qira financiare
 Deri ne 1 vit
 1 deri ne 5 vite
 Me shume se 5 vite
Totali, bruto

	Pagesat minimale 31 dhjetor 2017	Vlera aktuale e pagesave minimale 31 dhjetor 2017
1,627,862	1,222,737	
731,518	232,888	
182,879	146,290	
2,542,259	1,601,915	

Te ardhura financiare te pafituar

Deri ne 1 vit
 1 deri ne 5 vite
 Me shume se 5 vite
Totali, bruto

31 dhjetor 2017
 405,126
 498,629
 36,589
940,344

Pjesa afatshkurte
 Pjesa afatgjate
Totali, bruto:

31 dhjetor 2017
 379,179
 1,222,736
1,601,915

8. Aktive monetare dhe ekuivalentët me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to më 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

Llogari rrjedhëse:
 ne Leke
 ne Euro
Totali

31 Dhjetor 2017
 18,022,143
 14,817,821
32,839,964

MOGO ALBANIA SHA

Shënimë të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017

(shumat në Lekë)

9. Kapitali aksionar

Më 31 Dhjetor 2017, kapitali aksionar i regjistruar dhe i paguar është 20.000.000 Lekë, dhe përbëhet nga 2.000.000 aksione me vlerë nominale 10 Lekë. Struktura aksionare bazuar në kapitalin e paguar dhe të regjistruar më 31 Dhjetor 2017 është si vijon. Nuk ka pasur ndryshime ne strukturen dhe vleren e kapitalit gjate vitit 2017.

Aksionarët	31 dhjetor 2017		
	Ne %	Numer aksionesh	Ne lekë
Mogo Finance S.A.	100%	2,000,000	20,000,000
Totali	100%	2,000,000	20,000,000

10. Hua nga pale te lidhura

Hua nga pale te lidhura me 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017
Pricipali	23,931,000
Interesi i pagueshem	590,315
Totali	24,521,315

Shoqeria ka marre një linje kredie nga mëma, Mogo Financë, me limit në vleren Euro 15,000,000. Deri me 31 dhjetor 2017 huaja e marre eshte Euro 180,000 e paguar në katër këste. Kjo hua ka një normë interesi vjetore prej 12% dhe një date maturimi 27 prill 2023.

11. Detyrime per tatime dhe sigurime

Detyrime per tatime dhe sigurime me 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017
Detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore	281,051
Detyrime ndaj shtetit për tatim në burim	65,501
Totali	346,552

12. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera në datën 31 dhjetor 2017 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017
Shpenzime te perllogaritura	1,196,484
Detyrime ndaj furnitorëve	200,163
Detyrime të tjera	4,500
Detyrime ndaj punonjësve	2,644
Totali	1,403,791

Shoqeria ka llogaritur shpenzime te perllogaritura me 31 dhjetor 2017 per zarat e meposhtem:

	31 dhjetor 2017
Shërbime konsulencë	664,750
Leje te paperdorura	336,231
Shërbime informatike	100,430
Reklama	88,183
Energji elektrike	6,890
Totali	1,196,484

MOGO ALBANIA SHA

Shënimë të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

13. Shpenzime nga interesi, neto

	Periudha
	28 mars 2017 deri me
	31 dhjetor 2017
<i>Të ardhura nga interesat</i>	
Interesi nga aktiviteti i qirasë financiare	6,755
Komisioni i disbursimit	6,514
	241
<i>Shepenzime per interesat</i>	
Interesi nga huaja me palet e lidhura	(590,315)
Shepenzime nga interesat, neto	(583,560)

Te ardhurat nga interesit perfshijne të ardhurat nga interesit i qirase financiare dhe te ardhura nga komisioni i disbursimit të llogaritura për periudhën nga lidhja e kontratës deri në datën 31 dhjetor 2017.

Shpenzimet e interesit perfshijne interesat nga huaja e marre nga mëma me një norme interesit 12%, e llogaritur me bazë ditore.

14. Shpenzime operative

Shpenzimet operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

	Periudha
	28 mars 2017 deri me
	31 dhjetor 2017
Sherbime ligjore dhe noteriale	1,720,252
Konsulencë tatimore dhe kontabiliteti	1,265,515
Qira	1,196,192
Mirmbajtje dhe riparime	209,311
Reklama	129,506
Shepenzime utilitare	118,356
Sherbime te ndryshme	80,090
Komsione bankare	66,308
Tarifa dhe taksa vendore	71,279
Shepenzime provigjonimi	16,019
Te tjera	41,210
Totali	4,914,038

15. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

	Periudha
	28 mars 2017 deri me
	31 dhjetor 2017
Paga	4,494,698
Sigurime shoqërore	275,422
Shepenzime per leje te paperdorura	336,231
Totali	5,106,351

MOGO ALBANIA SHA

Shënime të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017
(shumat në Lekë)

16. Humbje nga kurset e këmbimit, neto

Humbjet nga kurset e këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë si më poshtë:

	Periudha
	28 mars 2017 deri me
	31 dhjetor 2017
Fitime nga kursi i këmbimit	64,758
Humbje nga kursi i këmbimit	(73,392)
Humbje nga kurset e këmbimit, neto	(8,634)

17. Tatim fitimi

	Periudha
	28 mars 2017 deri me
	31 dhjetor 2017
Shpenzime tatimi mbi fitimin	-
Tatim fitim i shtyre	1,544,043
E ardhur e shtyre nga tatim fitimi	1,544,043

	Periudha
	28 mars 2017 deri me
	31 dhjetor 2017
Humbja para tatimit	(10,613,847)
<i>Shpenzimet e pazbritshme</i>	320,227
Gjoba dhe demshperblime	10,000
Shpenzime amortizimi	303
Tatime dhe taksa te tjera	29,515
Shpenzime interesni	280,409
Rezultati tatimor per periudhen	(10,293,620)
Tatim i llogaritur per rezultatin tatimor te periudhes (15%)	(1,544,043)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-

Në përputhje me ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme për tatimin mbi fitimin për vitin 2017 është 15%.

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shoqëria për vitin 2017 rezulton me humbje tatimore prej 10,293,620 Lekë, i cili do te mbartet gjate 3 viteve te ardhshme. Shoqëria ka pritshmeri qe gjate tre viteve te ardhshme, do te realizoje fitime te mjaftueshme per te mbuluar humbjet e mbartur tatimore te vitit 2017. Per kete arsy, Shoqëria ka njojur aktiv tatimor te shtyre per tatimin qe pritet te kompensohet kundrejt shpenzimit te tatim fitimit te 3 viteve qe vijne, ne vleren 15% te humbjes tatimore, qe eshte 1,544,043 Lekë.

18. Palët e lidhura

Në tabelat e mëposhtme, shoqëria prezanton marrëdhëniet që ekzistojnë midis saj dhe palëve të lidhura me të, natyrën e transaksioneve, vlerat përkatëse, si dhe shpenzimet dhe të ardhurat deri më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017.

Drejtuesit e shoqërisë janë ata persona të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e aktiviteteve të saj, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo, përfshirë këtu edhe drejtues ekzekutivë, ose jo, të lartë të shoqërisë.

MOGO ALBANIA SHA

Shënime të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017

(shumat në Lekë)

18. Palet e lidhura (vazhdim)

Palët e tjera të lidhura të shoqërinë, që mund të janë aksionaret ose individë të lidhur me shoqërinë ose pjesëtarë të ngushtë të familjes së këtyre individëve, që kanë kontroll të plotë ose të përbashkët nga individët e lidhur me shoqërisë apo pjesëtarë të ngushtë të familjes së tyre, apo që kanë influencë të konsiderueshme mbi një entitet, prezantohen si Palë të tjera të lidhura të shoqërisë

Ne vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017, transaksionet me pale te lidhura i korrespondojnë shumave te paraqitura si më poshtë vijon:

Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet	31 dhjetor 2017		
	Drejtuesit e shoqerise	Palët e tjera te lidhura	Totali
Pasqyra e pozicionit financiare Huamarje (shenimi 11)	-	24,521,315	24,521,315
Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve Shpenzime Shpenzime te tjera	-	590,315	590,315

Për më tepër, pagat dhe shpërblimet për drejtimin e shoqërisë paraqitet si më poshtë:

Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2017		
	Paga	Bonus	Totali
Shpërblimi i drejimit të shoqërisë	3,984,778	-	3,984,778

19. Angazhime dhe detyrimet e kushtezuara

a. Detyrime për qiratë operative

Shoqeria ka marrë me qira zyren në Tiranë, ku ushtron aktivitetin e saj per një afat kontraktual 3 vjeçar me një pagese minimale mujore prej Euro 1,295 ne muaj (vlerë bruto). Angazhimet e ardhshme të qirasë për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2017 janë të detajuara si më poshtë:

Jo më shumë se një vit	31 dhjetor 2017		
	2,066,043	-	-
	2,789,158	-	-
	-	-	-
	4,885,201		

b. Angazhimet për qiratë financiare

Jo më shumë se një vit	31 dhjetor 2017		
	1,626,886	-	-
	731,518	-	-
	182,879	-	-
	2,541,283		

c. Pretendime per çështje ligjore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka çështje apo pretendime që do të kenë efekt negativ në pozicionin financier të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Gjithashtu, më 31 dhjetor 2017, Shoqëria nuk ka angazhime per investime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

MOGO ALBANIA SHA

Shënime të pasqyrave financiare për periudhen nga 28 mars deri me 31 dhjetor 2017

(shumat në Lekë)

20. Vlera e drejte

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim të shlyhet midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, të mirinformuara që kryejnë një transaksion në mënyrë të vullnetshme në datën e matjes.

Qira financiare – Te arketueshme nga qirate financiare mbahen neto duke u zbritur humbjet për zhvlerësim. Portofoli i qirave financiare të Mogo Albania ka një vlerë të drejtë të përllogaritur përafërsisht sa vlera kontabël.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to - Vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e afërt me vlerën e tyre kontabël per shkakt te natyres se tyre afatshkurter.

Hua nga palet e lidhura – Norma e interesit eshte fiks dhe eshte vleresuar se vlera e drejte i përafrohet vlerës se tregut.

Aktive te tjera - Vlera e drejtë e aktiveve të tjera, është përafërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Detyrime per tatime dhe sigurime - Vlera e drejtë e ketyre detyrimeve, është përafërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Detyrime te tjera - Vlera e drejtë e detyrimeve të tjera, është përafërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Duke qene se asnjë prej instrumenteve financiare te detajuara me larte nuk maten me vlere te drejte, nuk nevojitet te paraqitet informacion lidhur me nivelin e hierarkise se vleres se tyre te drejte.

21. Ngjarje të mëpasshme

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.